

Treguesit demografikë


Tremujori 3 2018

Tiranë, më 14 Nëntor 2018: Numri i lindjeve për tremujorin e tretë 2018 rezulton 6.859, duke shënuar një rënie prej 19,7 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2017. Numri i vdekjeve për tremujorin e tretë 2018 rezulton 4.640, duke shënuar një rënie prej 9,1 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2017.

Gjatë tremujorit të tretë 2018, numri i lindjeve tejkaloj me 2.219 numrin e vdekjeve.

Shtesa natyrore e popullsisë për tremujorin e tretë 2018, pasqyron një rënie me 35,4 %, në krahasim me tremujorin e tretë 2017.


Fig. 1 Shtesa natyrore e popullsisë



Në tremujorin e tretë 2018, shtesa natyrore e popullsisë për 12 qarqet e Shqipërisë, regjistron vlerën më të lartë në qarkun e Tiranës, ku numri i lindjeve tejkalon me 1.150 numrin e vdekjeve. Shtesë natyrore të lartë paraqet edhe qarku i Elbasanit me 281 lindje më shumë se vdekje, pasuar nga qarku i Durrësit me 260 lindje më shumë se vdekje.

Në tremujorin e tretë 2018, shtesa natyrore regjistron vlerë negative vetëm në tre qarqe (Gjirokastrë, Vlorë dhe Korçë). Vlera më e ulët është regjistruar në qarkun e Gjirokastrës, ku numri i vdekjeve tejkalon me 66 numrin e lindjeve.

Fig. 2 Lindjet, vdekjet dhe shtesa natyrore sipas qarqeve, T3 - 2018



Lindjet

Numri i lindjeve për tremujorin e tretë 2018 rezulton 6.859, duke shënuar një rënie prej 19,7 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2017.

Numri më i ulët i lindjeve regjistrohet në qarkun e Gjirokastrës, 111 lindje, me një rënie prej 26,0 %, në krahasim me tremujorin e tretë 2017. Numri më i madh i lindjeve regjistrohet në qarkun e Tiranës me 2.287 lindje, të cilat shënojnë rënie me 14,1 % në krahasim me tremujorin e tretë 2017.

Të gjitha qarqet e vendit pësuan rënie të numrit të lindjeve në tremujorin e tretë 2018, krahasuar me tremujorin e tretë 2017. Rënien më të madhe të numrit të lindjeve gjatë kësaj periudhe e paraqet qarku i Vlorës me 31,3 % dhe qarku i Korçës me 28,7 %.

Tab. 1 Lindjet sipas qarqeve

Qarqet	III - 17	IV-17	I - 18	II - 18	III - 18
Shqipëria	8,539	7,931	5,669	5,592	6,859
1 Berat	346	328	228	212	269
2 Dibër	449	443	257	342	360
3 Durrës	934	857	605	626	740
4 Elbasan	879	740	575	515	743
5 Fier	797	781	534	507	617
6 Gjirokastrër	150	158	96	87	111
7 Korçë	515	499	338	339	367
8 Kukës	306	255	186	196	225
9 Lezhë	398	406	285	255	348
10 Shkodër	618	483	400	426	462
11 Tiranë	2,661	2,529	1,872	1,851	2,287
12 Vlorë	441	423	273	221	303
*Të panjohur	45	29	20	15	27

*Kategoria 'Të panjohur' nënkupton numrin e lindjeve të gjalla për të cilat informacioni i qarkut, ku është regjistruar lindja, mungon.

Vdekjet

Numri i vdekjeve për tremujorin e tretë 2018 rezulton 4.640, duke shënuar një rënie prej 9,1 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2017.

Numri më i madh i vdekjeve regjistrohet në qarkun e Tiranës, me 1.137 vdekje, me një rënie prej 8,3 %, në krahasim me tremujorin e tretë 2017. Numri më i vogël i vdekjeve regjistrohet në qarkun e Kukësit, me 107 vdekje, me një rënie prej 14,4 %, në krahasim me tremujorin e tretë 2017.

Rënia më e madhe e numrit të vdekjeve në krahasim me tremujorin e tretë 2017, është regjistruar në qarkun e Fierit me 18,2 %.

Në tremujorin e tretë 2018, me rritje të numrit të vdekjeve paraqitet qarku i Durrësit me 10,6 % dhe qarku i Gjirokastrës me 3,5 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2017.

Tab. 2 Vdekjet sipas qarqeve

Qarqet	III - 17	IV-17	I - 18	II - 18	III - 18
Shqipëria	5,103	5,408	5,954	4,823	4,640
1 Berat	272	276	327	254	229
2 Dibër	229	186	248	182	189
3 Durrës	434	482	551	447	480
4 Elbasan	463	549	622	508	462
5 Fier	627	603	691	536	513
6 Gjirokastrë	171	199	213	165	177
7 Korçë	501	528	549	489	412
8 Kukës	125	142	136	124	107
9 Lezhë	221	244	242	222	196
10 Shkodër	446	454	485	419	383
11 Tiranë	1,240	1,338	1,429	1,088	1,137
12 Vlorë	363	404	455	385	355
*Të panjohur	11	3	6	4	0

* Kategoria 'Të panjohur' nënkupton numrin e vdekjeve për të cilat informacioni i qarkut ku është regjistruar vdekja nuk është i njohur.

Shënime metodologjike

1. Lindjet

Të dhënat e lindjeve

Të dhënat e lindjeve sipas gjinisë sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, e cila dërgon në INSTAT vetëm numrin e lindjeve të banuesve në Shqipëri. Konsiderohen të gjitha lindjet e banuesve në Shqipëri gjatë periudhës referencë, duke mos marrë parasysh lindjet e banuesve jashtë Shqipërisë (emigrantëve) edhe pse mund të regjistrohen në zyrat e gjendjes civile pranë ish-vendbanimeve të tyre.

Regjistrimet e vona të lindjeve

Kryhet një rregullim i vogël i numrit të lindjeve që regjistrohen vonë për vitin aktual, në mënyrë që të përfshijmë të gjitha lindjet e ndodhura në periudhën referencë. Numri i lindjeve të regjistruara vonë në vitin e mëparshëm janë konsideruar si një proxy për regjistrimet e vona të vitit aktual, duke konsideruar supozimin (si rezultat edhe i analizave tona të vazhdueshme) që numri i regjistrimeve të vona të lindjeve nuk ndryshon shumë nga viti në vit.

2. Vdekjet

Të dhënat e vdekjeve

Të dhënat e vdekjeve sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile sipas karakteristikave bazë demografike. Konsiderohen të gjitha vdekjet e banuesve në Shqipëri gjatë periudhës referencë, duke mos marrë parasysh vdekjet e banuesve jashtë Shqipërisë (emigrantëve) edhe pse mund të regjistrohen në zyrat e gjendjes civile pranë ish-vendbanimeve të tyre.

Regjistrimet e vona të vdekjeve

Bëjmë një rregullim të vogël të numrit të vdekjeve që regjistrohen vonë për vitin aktual, në mënyrë që të përfshijmë të gjitha vdekjet e ndodhura në periudhën referencë. Numri i vdekjeve të regjistruara vonë në vitin e mëparshëm janë konsideruar si një proxy për regjistrimet e vona të vitit aktual, duke konsideruar supozimin (si rezultat edhe i analizave tona të vazhdueshme) që numri i regjistrimeve të vona të vdekjeve nuk ndryshon shumë nga viti në vit.

Përkufizime:

Shtesa natyrore e popullsisë: Shpreh rritjen / rënien e popullsisë si rezultat i proceseve biologjike (lindjeve dhe vdekjeve) të saj gjatë një periudhe kohë. Ky tregues shprehet si diferencë ndërmjet lindjeve dhe vdekjeve.

Lindje e gjallë: Lindjet e fëmijëve që shfaqën shenja jete.

Vdekje: Nënkupton zhdukjen e përhershme të të gjitha shenjave të jetës në çdo kohë pasi ka ndodhur një lindje e gjallë (ndërprerjen e funksioneve vitale pa aftësinë e ringjalljes).

Burimi i të dhënave: Të dhënat merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.